

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Dr.sc.Driton Muharremi e Fillim Skoro, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve S.M. për shkak të veprës penale Ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK, të akuzuarës V.G., për shkak të veprës penale Shtytje në kryerjen e veprës penale Ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 lidhur me nenin 32 të KPRK dhe të akuzuarve V.G., M.S. dhe A.S. për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Dhënia e ryshfetit në tentativë nga neni 429 par.3 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës në Prishtinë të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë PKR.nr.338/2016 datë 28.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 23.10.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.338/2016 datë 28.05.2018, **vërtetohet.**

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.nr.338/2016 datë 28.05.2018, të akuzuarit S.M., V.G., M.S. dhe A.S. konform nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së i ka liruar nga akuza dhe atë S.M. për shkak të veprës penale Ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK, të akuzuarën V.G., për shkak të veprës penale Shtytje në kryerjen e veprës penale Ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 lidhur me nenin 32 të KPRK dhe të akuzuarit V.G., M.S. dhe A.S. për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Dhënia e ryshfetit në tentativë nga neni 429 par.3 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës. Paratë e konfiskuara në shumë prej 15.000,00€ i kthehen V.G.t.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

-Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me lirimin e të akuzuarve dhe vendimin mbi kthimin e parave në shumë prej 15.500,00 të pandehurës V.G..

-Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës kanë paraqitur mbrojtësit e të akuzuarve S.M., V.G., M.S. dhe A.S. me propozim që Gjykata e Apelit ta refuzojë ankesën e PSRK-së kurse aktgjykimin e ankimuar ta vërtetojë.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.452/18 të dt.08.10.2018, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, aktgjykimi të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje ndërsa të refuzohen përgjigjet në ankesën e PSKR-së të parashtruara nga mbrojtësit e të akuzuarve S.M., V.G., M.S. dhe A.S. si të pabazuara.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa nuk është e bazuar

Aktgjykimi i shkallës së parë ankimohet nga ana e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale duke konsideruar se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi janë vlerësuar vetëm provat dhe rrethanat lehtësuese për ti liruar të akuzuarit dhe për këtë qëllim fare nuk vlerësohen rrethanat fajësuese, tendencë kjo që manifestohet në tërë aktgjykimin e atakuar. Gjykata konstaton si fakt të vërtetuar takimin e të akuzuarit me gjyqtaren L.M. por për ta shfajësuar të njëjtin nga ushtrimi i ndikimit ndaj gjyqtarës L. gjykata potencon se bisedën e kishte iniciuar gjyqtarja L. dhe se i pandehuri M. nuk i kishte thënë gjyqtarës se në çfarë mënyre të vendos në këto dy lëndë, madje as ri cilësimin juridik të veprave penale apo lirimin e tyre nga paraburgimi. Prokuroria konsideron se gjykata anashkalon faktin se kjo “bisedë profesionale” nuk është zhvilluar në ndonjë institucion gjyqësor apo takim profesional të gjyqtareve por është zhvilluar në kafenenë “B...” në Prishtinë me iniciativën e S.M. me qëllim që të ndikoj tek gjyqtarja M1. për caktimin e shqyrtimit gjyqësor në rastin e F.D.. Edhe dëshmitarja M1. edhe i pandehuri M. pranojnë faktin se M. i ka thënë që të procedoj rastin kundër të pandehurit F.D.. Përkritazi me rastin e të pandehurit M.S., dëshmitarja ka theksuar se është konsultuar me tani të pandehurin M. përkritazi me elementet e veprës penale të krimit të organizuar, mirëpo si që ka thënë ajo pa përmendur emrat. Ka thënë se ajo dhe gjyqtarët tjerë shpesh janë konsultuar me kryetarin e atëhershëm të Gjykatës së Apelit, S.M. pasi i njëjti çmohet si ekspert në lëmin penale. Ka biseduar disa herë edhe për F.D. dhe i ka thënë se në atë lëndë për momentin nuk mund të veprojnë pasi ka lëshuar flet rreshtimin ndërkombëtarë. Prokuroria mbron qëndrimin se sugjerimi i të pandehurit S.M. si kryetar i Gjykatës së Apelit në atë kohë që të caktohet shqyrtimi gjyqësor vetëm ndaj të pandehurit F.D., paraqet ushtrim ndikimi të padrejtë pasi që një sugjerim i tillë ishte në kundërshtim direkt me qëndrimin e Gjykatës së Apelit i shprehur me aktvendimin PAKR.nr.100/2013 të datës 26.11.2013 që lënda penale kundër të pandehurit F.D. nuk mund të veçohet dhe se kjo lëndë duhet të bashkohet për të njëjtën çështje penale ndaj të pandehurve H.GJ. dhe F.GJ., e që sipas prokurorisë i pandehuri ka ditur për këtë qëndrim të Gjykatës së Apelit kryetar i së cilës ishte në atë kohë. Gjatë bastisjes në zyrën e të pandehurit M. është gjetur kopja fizike e aktvendimit PAKR.nr.100/2013 e datës 26.11.2013 e që provon faktin se i njëjti ka disponuar

me këtë aktvendim e që edhe vet i pandehuri ka pranuar se e ka ditur përmbajtjen e këtij aktvendimi dhe qëndrimin e Gjykatës së Apelit. Pavarësisht kësaj i njëjti ka ndikuar tek L.M. që sa më parë të caktohet shqyrtimi për të pandehurin F.D., kinse për shkak të zgjatjes së tepruar të paraburgimit. Provat dëshmojnë se këtë ndikim i pandehuri M. e kishte bërë i shtyrë nga V.G., e cila është bashkëshorte e të pandehurit F.D.. Provat me aplikimin e masave të fshehta e të administruara si prova dëshmojnë veprimin si dhe qëllimin e të pandehurit M. për të bërë favore të padrejta një të pandehuri ndaj të cilit zhvillohet procedurë penale për vepra të njëjta penale. Prandaj bazuar në provat e administruar konstatimi i gjykatës së shkallës së parë se nuk ka prova që i pandehuri S.M. ka kryer veprën penale nuk qëndron. Prokuroria përshkruan pjesë nga komentari i Kodit Penal të Kosovës lidhur me veprën penale të ushtrimit të ndikimit nga neni 431 par. 1 të KPRK-së e që vepra mund të kryhet me dobi materiale, përfitim tjetër që përbëjnë vlerat pronësore dhe jo pronësore e të jep të kuptohet se kjo vepër kryhet edhe me pranimin e shërbimeve seksuale si përfitim jo material. Sa i përket të pandehurës V.G. masat e fshehta kanë vërtetuar se e njëjta ka hyrë në raport seksual me të pandehurin M., për ta shtyrë që ti ndihmoj mikun e saj intim – të pandehurin M.S. dhe bashkëshortin e saj – të pandehurin F.D., e këtë me iniciativë të pandehurit M1. të cilin e informonte rregullisht gjatë vizitave të saja në burg dhe përmes telefonit për takimet që i kishte me S.M. ndërsa ai e këshillonte si të sillej dhe si të vepronte në raport me të pandehurin M.. Prokuroria ka përshkruar bisedën në mes M1. dhe V., V. me S.. I pandehuri S. në mbrojtje ka theksuar se nuk ka qenë në dijeni për rastin e M.S., mirëpo fakti që ai ka ditur për këtë vërtetohet nga takimi me R. bashkëshortin e të pandehurit M1.. Nga këto biseda të përgjuara u vërtetua plani i të pandehurve për procedimin e lëndës kundër të pandehurit F. dhe të arrihet ri cilësimi juridik dhe lëshimi i tij nga paraburgimi. Përkundër këtyre fakteve, gjykata e shkallës së parë çuditërisht edhe pse konstaton se masat e fshehta janë administruar si provë, në aktgjykim fare nuk i përmend dhe as që i vlerëson të njëjtat. Prokuroria konsideron se nga veprimi i të pandehurës V. dhe raporti i saj me të pandehurin S., me qëllim që ti ndihmoj në procedurë penale bashkëshortin e saj F.. dhe mikun e saj intim S1., konstatimin e gjykatës se nuk ka prova se e njëjta ka kryer vepër penale nuk qëndron. Fakti se V., M. dhe A. kanë planifikuar të japin ryshfet S.M. vërtetohet nga përgjimi ligjor e ku parat i quan këmisha ndërsa M1. i premton V. si shpërblim veturën kur të lirohet nga paraburgimi dhe e ka informuar të njëjtin që M. i ka pa këto para te ajo dhe prokuroria veçon bisedën e datës 14.03.2015 në mes të M1. dhe V..

Përgjigje në ankesën e PSRK-së ka ushtruar edhe mbrojtësi i të akuzuarit S.M., av. Ramë Gashi i cili ka theksuar se ankesa është e pabazuar edhe për faktin se aktvendimi për fillim të hetimeve ka filluar për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK-së dhe vperës penale ushtrim i ndikimit nga neni 431 par. 1 të KPRK-së. Me kërkesën për zgjerim të hetimit kundër S. M. janë zgjeruar hetimet edhe për vepër penale keqpërdorim i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK-së ashtu që procedura e hetimit është zhvilluar për këto tri vepra penale dhe hetimi ka zgjatur deri me 28.05.2016. Me 28.05.2016 ngritët aktakuza për shkak të dy veprave penale nga neni 422 por jo edhe për veprën penale nga neni 431 par. 1 të KPRK-së, që do të thotë se prokuroria i ka pushuar hetimet për këtë vepër penale pasi nuk ka ngritur aktakuzë dhe se hetimi ka pushuar automatikisht me kalimin e afatit kohorë nga neni 159 i KPP-së. Gjykata e Apelit me aktvendim e ka hudhë akuzën për njëjërën nga veprat penale nga neni 422 të KPRK-së i cili është vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, dhe është proceduar vetëm me një akuzë nga neni 422 i KPRK-së. Në

fjalën përfundimtare prokuroria me shkrim bazuar në nenin 350 par. 1 të KPK-së me parashtrësën PPS.nr.38/2015 të datës 24.05.2018 ka ndryshuar akuzën duke hequr veprën penale nga neni 422 të KPRK-së dhe duke akuzuar S. Mekën për veprën penale ushtrim të ndikimit nga neni 431 par. 1 të KPRK-së pra për veprën penale për të cilën është pushuar hetimi dhe është e parëndësishme nëse hetimi ka pushuar me aktvendim të prokurorit apo me automatizëm sipas fuqisë së ligjit. Nuk është administruar asnjë provë e re që do ta lejonte ndryshimin e aktakuzës e që të ketë treguar se gjendja faktike ka ndryshuar. Konsideron se aktgjykimi nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale se është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendja faktike.

Mbrojtësi i të akuzuarës V.G. av. B.B., në përgjigje në ankesë i propozon Gjykatës së Apelit që të vërtetoj nëse ankesa e prokurorisë është ushtruar brenda afateve kohore, të parapara nga neni 380 pika 1 i KPP-së dhe në rast se e njëjta është ushtruar pas kalimit të afatit kohorë dhe propozon që të hudhet ankesa në fjalë si e paafatshme. Nëse ankesa është e afatshme i propozon gjykatës të vërtetoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë pasi aktgjykimi përmban arsye të qarta për faktet vendimtare të vërtetuara dhe është bazuar në faktet dhe provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.S., av. E.M. në përgjigjen në ankesën e PSRK-së thekson se ankesa nuk përmban ndonjë fakt të ri por vetëm përshkruan edhe njëherë telefonatat e përgjuara në mes të pandehurve. Atakimet veç e veç në ankesë nuk kanë ndonjë bazë juridike e as faktike por tendencën e prokurorisë që të bëjë ndërlidhjen e kronologjisë të fakteve, pa pasur ndonjë bazë logjike.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.S., av. N.B. propozon që të refuzohet ankesa e prokurorisë dhe aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet pasi që aktgjykimi nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e po ashtu nuk ka mundur prokuroria të vërtetoj me prova pretendimin e saj përkitazi me të mbrojturin e tij pasi që askush nuk ka përshkruar apo përmendur ndonjë veprim të mbrojturit të tij të kundërligjshme që janë bërë para aktvendimin mbi zgjerimin e hetimeve.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesë nga Prokuroria e as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Nga ankesa e prokurorisë nuk rezulton asnjë shpjegim apo arsye se ku qëndrojnë këto shkelje. Pretendimet e prokurorisë janë përfolje e gjithë këtij procesi penal që nga stadi i procedurës paraprake duke përfshirë atë të hetuesisë dhe të akuzimit. Ankesa përmban të njëjtat stereotipe – pretendime të njëjta , duke paraqitur në mjetin juridik bisedat në mes të pandehurit S.M. dhe V.G. duke mos ofruar asnjë argumentim në favor të shkeljeve të pretenduara me ankesën e sajë. Nuk është e mjaftueshme që ankuesi vetëm ti parafrazoj shkeljet por duhet të jep arse të qarta për secilën shkelje të pretenduar se ku qëndrojnë ato. Në ankesë nuk është dhënë asnjë sqarim se pse aktgjykimi nuk qenka i përpiluar konform nenit 370 të KPP, se ku qëndron shkelja e Ligjit Penal (janë disa shkelje nga kjo bazë), cila provë nuk qenka proceduar nga gjykata e shkallës së parë e që gjendjen e fakteve e bën jo të plotë. Arsyetimi i ankesës duhet të paraqes dispozitivin e sajë – duhet arsyetuar se cili pretendim veç e veç. Mënyrën se si ankuesi e ka paraqitur ankesën , kjo gjykatë e ka të pamundur të identifikoj se çka ka konsideruar prokuroria shkelje ligjore

procedurale, shkelje të ligjit material dhe çka defekt në fushën e fakteve. Në “arsyetim” në faqen 2, kemi vetëm një nëntitull “në aktgjykimin e atakuar janë vlerësuar vetëm provat dhe rrethanat lehtësuese”, e që rrethanat lehtësuese vijnë në shprehje vetëm me rastin e matjes së dënimit dhe kur kemi të bëjmë me aktgjykim lirues ndërsa pjesa tjetër e “arsyetimit” prej 17 faqesh, pa asnjë shkëputje është përsëritje e tërë procesit nga faza e hetimit deri në shqyrtimin gjyqësor, pa konkretizuar asnjë shkelje që pretendohet. Një mënyrë e tillë e ankesës vetëm për nga titulli përmban arsyetim ndërsa de fakto ankesa është e pa arsyetuar. Bazë ankimore prokurorja thekson vendimin për lirim nga akuza, shkelje kjo që nuk ekziston në KPP por ekziston vetëm vendimi për dënim si bazë ankimore.

Në këtë ngjarje nuk është kontestuese se F.D., bashkëshort i të akuzuarës V.G. ndodhej në paraburgim për një vrasje dhe se ndaj tij po zhvillohej një proces gjyqësor në Gjykatën Themelore të Pejës, se ndodhej në paraburgim edhe M.S. për veprën penale Trafikim me narkotik dhe ky i fundit ishte në lidhje dashurie me të akuzuarën V.G.. E njëjta nën pretekstin për përshpejtim të procedurës ndaj bashkëshortit të sajë kishte kontaktuar të akuzuarin S.M. që ky takim fillimisht ishte i ligjshëm dhe etik, bazuar në faktin se i akuzuari S.M. ishte kryetar i Gjykatës së Apelit dhe kishte nën juridiksionin e përgjegjësishë të gjitha gjykatat themelore dhe sipas ligjit për çdo ankesë që palët i adreson tek ai ka pasur detyrim që të kërkoj nga gjykata kompetente shpjegim se në çfarë faze ndodhet procesi por edhe tui sugjeroj për respektimin e standardeve kur kemi të bëjmë me liritë dhe të drejtat e njeriut gjegjësisht përshpejtimin e procesit. Nga shkresat e lëndës del e pa kontestueshme se komunikimi në mes të akuzuarit S.M. shpeshtohet dhe merr dimension jo zyrtar porse të njëjtin e bën të paligjshëm vetëm në aspektin etik nga se jo çdo takim ex-parte njëkohësisht është edhe vepër penale. Veprimet e tilla nuk marrin dimension penal dhe ngelin vetëm në kuadër të shkeljeve etike pasi nuk përmbushet asnjë element i veprës penale për të cilat i pandehuri ngarkohet me çka me të drejtë ka theksuar edhe gjykata e shkallës së parë.

Nga shkresat e lëndës shihet se organi i akuzës fillimisht të akuzuarin S.M. e ka ngarkuar me tri vepra penale: dy keqpërdorime të detyrës zyrtare dhe një ushtrim ndikimi, dhe se me rastin e ngritjes së akuzës të njëjtin e akuzon për dy vepra penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare por jo edhe për veprën penale të ushtrimit të ndikimit e që de fakto dhe de jure për këtë vepër penale janë pushuar hetimet. Në shqyrtimin fillestar të akuzës, e me rastin e paraqitjes së kundërshtimeve nga mbrojtësit lidhur me ligjshmërinë e akuzës, gjykata themelore i ka refuzuar këto kundërshtime, mirëpo me ankesën e të akuzuarit S.M., Gjykata e Apelit ka miratuar ankesën dhe e ka hedh akuzën për një vepër penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Në këto rrethana të akuzuarit S.M. i mbeti vetëm një vepër penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, që ishte objekt akuze në gjykatën e shkallës së parë, mirëpo prokurorja e rastit duke parë se akuza e sajë është pa mbështetje në prova përpos në supozime, në fjalën përfundimtare e ndryshon cilësimin juridik dhe atë nga keqpërdorimi i detyrës apo autoritetit zyrtar në veprën penale ushtrimi i ndikimit, e për të cilën u tha më lartë se hetimet janë pushuar nga se bëhet fjalë për ngjarjen e njëjtë. Me këtë veprim të prokurores rasti apriori ka qenë i kompromituar, përkundër faktit se organi i akuzës nuk e ka konstatuar formalisht pushimin e hetimit për këtë vepër penale, sepse ajo nuk e ka akuzuar të pandehurin për ushtrim ndikimi dhe në rrethana të tilla hetimi ex lege konsiderohet i pushuar për këtë vepër penale dhe ai më për të njëjtën penale nuk mund të akuzohet (bëhet fjalë për veprime të njëjta). Gjykata

mund ta ndërroj cilësimin juridik ku nga provat që procedohen në shqyrtimin gjyqësor del se gjendja faktike është ndryshe në raport me gjendjen e fakteve që prokurori e kishte konstatuar gjatë fazës së hetimit dhe akuzimit. Mirëpo këtu nuk bëhet fjalë për këtë situatë pasi gjendja faktike është po ajo që ishte në fazën e hetimit dhe akuzimit, për asnjë detaj nuk ka ndryshuar ngjarja (vepra penale), pastaj për këtë vepër penale tani më veç ishte pushuar hetimi, nga se prokurori edhe pse të pandehurin e kishte hetuar edhe për këtë vepër penale, në momentin e ngritjes së akuzës nuk e kishte akuzuar për këtë vepër penale.

Edhe pse u sqarua më lartë, se prokurorja nuk ka mundur në shqyrtimin gjyqësor ta ri cilësojë veprën penale, për të njëjtën vepër penale (ushtrim ndikimi) nga e cila kishte hequr dorë me rastin e akuzimit dhe hetimit “ex lege” për këtë vepër penale konsiderohet si i pushuar, megjithatë gjykata e gjen të arsyeshme për të dhënë sqarime, për mosekzistimin e asnjë elementi të kësaj veprë penale, edhe sikur organi i akuzës të kishte akuzuar të pandehurin për këtë vepër penale, me rastin e ngritjes së aktakuzës. Përfundimet e gjykatës së shkallës së parë për mos përmbushjen e elementeve esenciale përkitazi me veprën penale ushtrim i ndikimit, janë të drejta dhe të mbështetura në prova, që janë proceduar në këtë çështje penalo-juridike për këtë arsye.: organi i akuzës në ankesën e vetë si provë që po i vërtetuaka faktet lidhur me ndikimin e të pandehurit S.M. në gjyqtaren L.M. i merr kontakte komunikimet, lidhja intime si dhe fotot e shkëmbyera në mes të pandehurit S. me të pandehurën V., pastaj takimet e të pandehurit S. me gjyqtaren L. për të biseduar mundësinë e përshpejtimit të procesit penal që zhvillohej ndaj të pandehurit F.D. përndryshe bashkëshort i të pandehurës V.G.. Kontaktet komunikimet e pastaj edhe raportet intime në mes të pandehurit S. dhe të pandehurës V..

Nëse analizohet përshkrimi ligjor i veprës penale ushtrim ndikimi shohim se : “kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë , në mënyrë që të ushtroj ndikim të padrejtë mbi vendimmarrjen e personit zyrtar apo zyrtarit publik të huaj pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar shpie deri te rezultati i synimeve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 8 vjet. Kështu që pa dimensionin e parë (komunikimet kalimi në raporte intime me të pandehurën V.) veprimet e të pandehurit S. (takimet e tij me gjyqtaren e ngarkuar me çështjen penale L.) për përshpejtimin e procedurës penale, në raport me të pandehurin F.D. dhe diskutimi për çështje tjera profesionale, janë veprime të ligjshme. Kur kemi të bëjmë me të drejtat dhe liritë e njeriu (paraburgimi) sipas të drejtës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare të gjitha institucionet duhet të veprojnë me urgjencë, që paraburgimin ta limitojnë në afat sa më të shkurtër, ndërsa kryetari i gjykatës përkatëse pastaj kryetari i Gjykatës së Apelit, kryetari i Gjykatës Supreme detyrohen që të kërkojnë nga gjyqtarët që sa më shpejtë ta procedojnë dhe ta përfundojnë çështjen penale, dhe brenda këtyre autorizimeve ka qenë edhe i pandehuri S.M. si kryetar i Gjykatës së Apelit, në vartësinë e të cilit kanë qenë të gjitha gjykatat themelore.

Gjyqtarja L.M. përndryshe gjyqtare e ngarkuar në këtë çështje penale nga i pandehurit F.D. bashkëshort i të pandehurës V.G. e dëgjuar si dëshmitare ka deklarua: “me të pandehurin jamë konsultuar shpesh për çështje të ndryshme profesionale, nga se e kam pas kryetar dhe kam konsideruar ekspert të pakontestuar të fushës penale, kemi biseduar edhe për mundësinë e përshpejtimit

të çështjes në ngarkesë të pandehurit F.D., përpos çështjeve tjera kam biseduar edhe për rastin e të pandehurit M.S. (vetëm për kundërshtimet e mbrojtësve që i kishin paraqitur) por i pandehuri as që e ka përmendur çështjen e ricilësimit të veprës penale, dhe ai kurr nuk ka kërkuar diçka të paligjshme dhe asgjë më tepër, përpos për respektimin e standardit kur i pandehuri ndodhet në paraburgim”. Kërkesa e të pandehurit S.M. si kryetar i Gjykatës së Apelit drejtuar gjyqtarës L.M. që të shikohet mundësia e përshpejtimit të procedurës penale ndaj F.D. pastaj diskutimi profesional i një çështje penale pa u përmendur emrat, nuk është ndikim për vendim të padrejtë (si tipare qenësore e kësaj vepre penale), përkundrazi është veprim i drejtë i ligjshëm, së dyti kërkesa e të pandehurit që të veçohet lënda në raport me F.D. dhe të procedohet veçmas nga të pandehurit e tjerë që ishin në arrati, është veprim i ligjshëm dhe i drejtë, jo veprim i pa drejtë, siç pretendon prokurorja me ankesë dhe siç kërkohet me nenin 431 të KPK. Pavarësisht se çfarë ka vendos një kolegji i Gjykatës së Apelit (për mos ndarje të çështjes penale) gjykatat kur kemi të bëjmë me bashkëkryerës dhe kur ndonjëri nga ata ndodhet në arrati, sipas ligjit është e detyruar që ta veçojë çështjen penale, dhe ta përfundojë me ata të pandehur që janë të qasshëm, s’mund të sakrifkohet dhe të mbahet në paraburgim i bashkëpandehuri që është në paraburgim pafundësisht, derisa të bëhen të kapshëm të bashkëpandehurit e tjerë (është detyrim ligjor që në raste të tilla çështja të ndahet dhe të procedohet vetëm ai që është i çastshëm ndërsa veprimet e gabuara – të paligjshme të kujdo qofshin ato nuk mund të prodhojnë efekte juridike).

Rezulton se, meqenëse i pandehuri kishte qenë gjyqtar i Gjykatës Supreme, gjyqtar i ish Gjykatës së Qarkut në Pejë, kryetar i Gjykatës Themelore në Pejë, dhe shquhet si ekspert i fushës penale çdoherë që kthehej në këtë gjykatë (kthehej shpesh se e kërkonin vetë gjyqtarët) pyetje nga gjyqtarët për çështje të ndryshme penale, për të marrë opinionin e tij dhe sipas interpretimit të organit të akuzës çdo dhënie e opinionit të tij për një çështje profesionale qenka o keqpërdorim i detyrës zyrtare o ushtrim ndikimi?!

Pretendimet e prokurorës nga ankesa se kinse i pandehuri S.M. paska ndikuar te gjyqtarja L. për të përshpejtuar rastin që ka të bëjë me të pandehurin F.D. dhe paska ndikuar për ricilësimin e padrejtë të veprës penale, në raport me të pandehurin M.S. del të jenë vetëm supozime –hamendësim i organit të akuzës, nga se këtë nuk e thot gjyqtarja-dëshmitarja, ndërsa prokuroria nuk ka paraqitë asnjë provë lidhur me këtë. Nuk është e qartë se si organi i akuzës e konsideron ushtrim ndikimi, kur vetë personi për të cilin pretendohet se është ndikuar (gjyqtarja L.) ka deklaruar: se në asnjë mënyrë i pandehuri S. nuk ka kërkuar nga unë diç tjetër përpos mundësisë së përshpejtimit të procesit penal në raport me F.D.n dhe se ajo ka kërkuar mendimin e tij edhe lidhur me kundërshtimet e mbrojtësve që i kishin paraqitur lidhur me rastin e të pandehurit M.S. por se i akuzuari S. nuk ka kërkuar në asnjë moment ricilësimin e veprës penale apo diçka tjetër të pa drejtë siç pretendon prokuroria me aktakuzë. Nga sa u tha më lartë rezulton se aktgjykimi i shkallës së parë përkitazi me të akuzuarin S.M. është i ligjshëm dhe nuk përmban asnjë shkelje të pretenduar në ankesë të prokurorisë, edhe pse siç u theksua më lartë ankuesi nuk jep arsye se pse këto shkelje ekzistojnë.

Po ashtu pretendimet ankimore të prokurorisë dalin të jenë të pa bazuara ndërsa vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë i drejtë edhe në raport me të akuzuarën V.G. dhe M.S. sa i përket veprës penale shtytje në veprën penale

ushtrim i ndikimit. Ashtu siç u tha më lartë nuk janë kontestuese komunikimet, raportet në mes të pandehurit S.M. dhe V.G., nuk është kontestuese se V.G. nga babai i të pandehurit M.S. , A.S. ka marr 25 .000 euro kinse për ti dhënë të pandehurit S.M., gjithashtu nuk është kontestuese se ajo nuk ka tentuar fare që këto para të ja jep të akuzuarit S.M.. Sa i përket veprës penale Shtytje për ushtrim ndikimi nuk është përmbushur asnjë nga elementet e kësaj vepre penale nga se shtytja është e lidhur me veprën penale ushtrim i ndikimit nga i pandehuri S.M., për të cilën u arsyetua më lartë se me asnjë provë nuk është provuar se i akuzuari S. ka kryer veprën penale të ushtrimit të ndikimit. Shtytja mund të kryhet në dy forma dhe atë : 1. E para duke ndikuar në mënyra të ndryshme që kryesi të marr vendim për të kryer veprën penale dhe 2.: kur kryesi ka marr vendim për të kryer veprën penale por akoma hamendet dhe shtytësi me veprime të ndryshme e forcon këtë vendim. Në rastin konkret nuk e kemi asnjërën situatë, se i akuzuari S.M. kurr nuk ka deklaruar se të akuzuarit kanë tentuar ta shtyjnë atë për të ushtruar ndikim të paligjshëm, ndërsa me të pandehurin M.S. nuk ka kontaktuar kurr kështu që si ka mundësi që i njëjti të ndikoj tek i akuzuari S.? Pastaj edhe në rastin e të akuzuarës V.G. dhe M. S., për arsyet e njëjta që janë dhënë në pjesën që ka të bëjë me të akuzuarin S.M., prokurorja nuk ka mundur në fjalën përfundimtare ta ricilësojë veprën penale në shtytje për ushtrim ndikimi nga se për këtë vepër penale ishte pushuar hetimi.

Po ashtu përkitazi me të akuzuarit V.G., M.S. dhe A.S. nuk është vërtetuar me asnjë provë se të njëjtit kanë kryer veprën penale dhënia e ryshfetit në tentativë. Prokuroria në anksën e saj thekson transkriptet e bisedave telefonike nga përgjimet dhe atë bisedat në mes te akuzuarit S. M. dhe te akuzuarës V.G. mirëpo në përmbajtjen e tyre nuk mund te formësohen elementet e figurës së veprës penale shtytje ne kryerjen e veprës penale ushtrim i ndikimit ashtu siç u vërtetua edhe mungesa e elementeve te veprës penale ushtrim i ndikimit nga ana e të akuzuarit S.M.. Siç e thamë më lart nuk është kontestuese se V.G. dhe S.M. kanë komunikuar ne telefon, por ne këto biseda nuk është përmendur tentimi per dhënjen e ryshfetit. Gjykata e shkalles se Pare ka theksuar që nuk ka qenë kontestuese dorëzimi i parave te e akuzuara V.G. dhe dorëzimi i tyre motrës se saj D.G. për çështje te sigurisë, mirëpo me asnjë provë tjetër nuk është vërtetuar premtimi i kësaj të akuzare te akuzuarit S. M. se veprimet qe ai do ti ndërmer do ti ofrohet ose ti jetë premtuar para e për me tepër e akuzuara V. nuk është person zyrtarë dhe dorëzimi i tyre V.G.t nuk konsumon elementet e veprës penale te dhënies se ryshfetit ne tentativë, ashtu qe ne mungesë të këtyre elementeve me te drejtë Gjykata e shkalles se parë i ka liruar nga akuza. E po ashtu edhe faktin se i akuzuari S.M. nuk kishte dijeni për këto para dhe nuk u vërtetua se e akuzuara V. kishte kërkuar nga i akuzuari S. qe te ndikoj te gjyqtarja L.M.

Meqë në aktgjykimin e atakuar nuk kemi shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nuk kemi as shkelje të ligjit penal.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Procesmbajtësja,
Eroll Gashi_____

Kryetari i kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj _____

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi_____

3. Fillim Skoro_____